

# MITROVICË: SERBIA JASHTË!

## LËVIZJA PËR BASHKIM

1

### Veriu i Mitrovicës

Pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës jo vetëm para luftës së fundit, por edhe deri në vitin 2000 ka qenë e banuar me mbi 70% shqiptarë.

2

### Dëbimi

Si pjesë e planit të Serbisë shqiptarët u dëbuan dhe po vazhdojnë të dëbohen me dhunë nga pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës, kurse në pronat e shqiptarëve u vendosën dhe po vendosen serbët. Ky spastrim etnik u krye dhe po kryhet para syve të ndërkombëtarëve dhe me miratimin e heshtur të tyre. Sidoqoftë, shumica e shqiptarëve të veriut të qytetit janë akoma pronarë të ligjshëm të pasurive të veta atje.

3

### Politika e gabuar

Qeveritë e deritanishme të Kosovës e kanë përcjellë këtë gjendje me indiferentizëm dhe kështu e kanë ndihmuar kolonizimin e veriut të Mitrovicës. Derisa qeveria e Serbisë po e vazhdon luftën dhe po i terrorizon shqiptarët e veriut të Mitrovicës, institucionet kompetente ndërkombëtare të sigurisë po bëjnë sehir! ▶

# MITROVICË: SERBIA JASHTË!

▶ Ndërsa Qeveria e Kosovës, në vend se të intervenojë në zbatimin e ligjit dhe kthimin e sigurisë në këtë pjesë të Kosovës, po propagandon investime parash, investime të cilat, nëse shqiptarët nuk kthehen në pronat e veta, do të jenë në dobi të kolonëve të rinj.

4

### Decentralizimi - ndarje juridike

Me Pakon e Ahtisarit parashihet formimi i dy komunave në qytetin e Mitrovicës, çka do të thotë ndarje edhe juridike e qytetit dhe pranim i gjendjes së krijuar me dhunë e terror.

5

### Qytetarët të kthehen në pronat e veta

Të gjithë banorët e Mitrovicës pa dallim etnie duhet të kthehen në pronat e veta. Kjo është një e drejtë elementare e cila garantohet me të gjitha konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, por edhe me kushtetutën e Kosovës.

6

### Të bashkohet Mitrovica

Duhet të përdoren të gjitha mjetet e mundshme për ta bashkuar Mitrovicën! Të mos lejojmë që para syve tanë të kryhen krime ndaj popullatës shqiptare të Mitrovicës dhe kështu spastrimi etnik të bëhet fakt i kryer. Përdorimi i të gjitha mjeteve për ta realizuar këtë qëllim është një e drejtë e patjetërsueshme e mbarë popullit shqiptar. Veprimi institucional i Qeverisë do ta shmangte nevojën për mjete tjera.